

## AKT THEMELIMI

### I

## SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### "Klinika Arbri"

Sot, më datë 03/04/2024,

**Brikeno Shegaj** shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 26/08/1987, lindur në Shkodër me nr. ID I70826100O, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037512939 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit,

**Arsit Hoxha** shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 06/05/1995, lindur në Shkodër me nr. ID: J50506095B , mbajtës i letërnjoftimit me Nr 036583816 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit,

vendosen të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

### NENI 1

#### Themelimi

Emri i shoqërisë është "**Klinika Arbri**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**Klinika Arbri**" Sh.P.K.

### NENI 2

#### Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Klinikës mjeksore, Laborator mjeksor. Paisje mjeksore dhe shitje suplementesh.

### NENI 3


#### Emri dhe vula e Shoqërisë


Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Klinika Arbri**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

### NENI 4

#### Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Klinikës mjeksore, Laborator mjeksor. Paisje mjeksore dhe shitje suplementesh.

Arsit Hoxha  


Brikeno Shegaj  




## NENI 5

### Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodrës me adresë: Shkodër, Lagjja Skenderbeg, Rruga Kolë Heqimi, Nr.pasurie 9/479+2-4/2, zona kadastrale nr 8592.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## NENI 6

### Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **100.000** (Njëqind mijë) lekë, i ndarë në 2 kuota ku kuota ka vlerën **100.000** lekë.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare me emrin "**Klinika Arbri**" zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**Brikeno Shegaj** shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 26/08/1987, lindur në Shkodër me nr. ID I708261000, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037512939 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% të kapitalit, ku një kuotë ka vlerën **50.000** lekë.

**Arsit Hoxha** shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 06/05/1995, lindur në Shkodër me nr. ID: J50506095B, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 036583816 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% të kapitalit, ku një kuotë ka vlerën **50.000** lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

## NENI 7

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 8

### Administratori

Arsit Hoxha  
AR

Brikeno Shegaj



Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

#### **NENI 9**

##### **Caktimi i Administratorit**

Administrator caktohet Z. **Arsit Hoxha** shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 06/05/1995, lindur në Shkodër me nr. ID: J50506095B me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi të kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 12**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 13**


Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

#### **NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Brikeno Shegaj**



**Arsit Hoxha**

